



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
Këshilli Drejtues

V E N D I M

Nr.2696, datë 17.11.2016

për

Shqyrtimin e Ankimit Administrativ të sipërmarrësit Albtelecom sh.a. për: Ndryshimin e Vendimit të Këshillit Drejtues Nr. 2689, datë 22.09.2016 për miratimin e dokumentit "Rregullore për mënyrën e zbatimit të Portabilitetit të Numrit", për ndryshimin e përmbajtjes së Rregullores bashkëlidhur këtij vendimi në lidhje me trajtimin e trafikut ndërkombëtar drejt numrave të portuar dhe në lidhje me disa elemente të tjerë operationale të funksionimit të procesit të portabilitetit të numrit.

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Anila	Denaj	Anëtar
4. Znj. Ketrin	Topçiu	Anëtar
5. Znj. Klarina	Allushi	Anëtar

dhe sekretare Sara Reçi, në mbledhjen e datës 17.11.2016, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 "Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe Rregullores së Brendshme të AKEP, miratuar me Vendimin Nr. 2506, datë 30.10.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

Shqyrtimin e Ankimit administrativ të sipërmarrësit Albtelecom sh.a. për: Ndryshimin e Vendimit të Këshillit Drejtues Nr. 2689, datë 22.09.2016 për miratimin e dokumentit "Rregullore për mënyrën e zbatimit të Portabilitetit të Numrit", për ndryshimin e përmbajtjes së Rregullores bashkëlidhur këtij vendimi në lidhje me trajtimin e trafikut ndërkombëtar drejt numrave të portuar dhe në lidhje me disa elemente të tjerë operationale të funksionimit të procesit të portabilitetit të numrit.

BAZA LIGJORE:

1. Ligji Nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë";
2. Ligji nr. 9918, datë 19. 05. 2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar (*ligji nr. 9918*);

K Ë SHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor si më poshtë:

1. Shkresa “Ankimi Administrativ” i Albtelecom sh.a. me nr. 8677Prot. datë 21.10.2016 (Prot. i AKEP nr. 1706 Prot, datë 21.10.2016).
2. VKD nr. 2689, datë 22.09.2016 për miratimin e dokumentit: “Rregullore për mënyrën e zbatimit të Portabilitetit të Numrit”.
3. Relacioni përkatës;
4. Projektvendimi i KD i formatuar dhe arsyetuar;
5. Diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, si dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

- I. Albtelecom sh.a. nëpërmjet këtij ankimi kërkon ndryshimin e Vendimit të Këshillit Drejtues Nr.2689, datë 22.09.2016 për miratimin e dokumentit "Rregullore për mënyrën e zbatimit të Portabilitetit të Numrit", për ndryshimin e përmbajtjes së Rregullores bashkëlidhur këtij vendimi në lidhje me trajtimin e trafikut ndërkombëtar drejt numrave të portuar dhe në lidhje me disa elementë të tjerë operacionale të funksionimit të procesit të portabilitetit të numrit.

AKEP, trajton këtë Ankim Administrativ të paraqitur nga sipërmarrësi Albtelecom sh.a., bazuar në parashikimet e Ligjit nr. 9918/2008 i ndryshuar, nenin 130 e në vijim të Kodit e Procedurave Administrative. Për trajtimin e këtij ankimi administrativ, AKEP, ka marrë në konsideratë gjithashtu, edhe arsyetimin e bërë nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, në Vendimin me nr. 2459, datë 9.9.2016, ku në paragrafin nr. 40 e në vijim është trajtuar çështja e vendimmarrjes nga AKEP, mbi ankimet administrative.

1. Baza ligjore që referon Albtelecom sh.a. në mbështetje të këtij ankimi është: Nenet 130/1, 131, 132, Nenet 133, 134/1,a, dhe 136/4, të Ligjit Nr.44/2015 dt. 30.04.2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", neni 7, neni 34, 35, 58/1, e vijues i Ligjit Nr. 9918, datë 19.05.2008 "Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
2. Albtelecom sh.a. në ankimin e tij lidhur me trajtimin e trafikut ndërkombëtar drejt numrave të portuar pretendon se, impaktet negative financiare të konsiderueshme për Albtelecom do vijojnë të jenë nëse, AKEP nuk ndryshon përcaktimet rregullatore në fuqi sipas të cilave thirrjet ndërkombëtare drejt numrave të portuar tarifohen aktualisht me tarifën e thirrjeve kombëtare.
3. Albtelecom sh.a., kërkon që përcaktimet rregullatore në fuqi duhet të ndryshojnë duke reflektuar parimin dhe implementimin standart të Portabilitetit të Numrit edhe në Europë.
4. Albtelecom sh.a., i kërkon AKEP reflektimin në nenin 8 të Rregullores së miratuar të Portabilitetit të Numrit, ku duhet patjetër të përfshihet edhe sanksionimi i parimit për trajtimin e thirrjeve ndërkombëtare drejt numrave të portuar në bazë të origjinës së CLI-së dhe rrjedhimisht të kryhen më pas edhe ndryshimet në Vendimet nr. 1559-1561, dt.20.04.2011 në lidhje me tarifën e terminimit të thirrjeve ndërkombëtare drejt numrave të portuar.

5. Domosdoshmëria për këtë përcaktim, sipas Albtelecom sh.a., vjen pikërisht në kushtet kur kuadri rregullator ka derregulluar regjimin e trafikut ndërkombëtar duke lënë të rregulluar atë pjesë të trafikut që terminohet në numra të portuar. Albtelecom sh.a., shprehet se, përcaktimi rregullator i deri tanishëm për tarifimin njëlloj të thirrjeve ndërkombëtare me ato kombëtare drejt numrave të portuar, duhet të ndryshojë patjetër dhe të sillet nën kushtet e ligjëruara tashmë të regjimit përkatës të derregullimit dhe sanksionimit e këtyre ndryshimeve në Rregulloren e miratuar nga AKEP.

Sa më sipër parashtron në ankim Albtelecom sh.a., AKEP sqaron se:

1. Siç shprehet edhe Albtelecom sh.a. në ankimin e tij, këto çështje janë trajtuar edhe në procesin e këshillimit publik me të interesuarit përpara miratimi të Rregullore për mënyrën e zbatimit të Portabilitetit të Numrit. AKEP, në qëndrimin për këtë çështje në periudhën e këshillimit është shprehur se, këto komente të sipërmarrësit Albtelecom sh.a. për çështje të trafikut, nuk janë pjesë e këtij këshillimi për miratimin e kësaj Rregulloreje, për shkak se dalin jashtë objektit të rregullore.
2. AKEP, sqaron se dokumenti “Rregullore nr. 43 datë 22.09.2016 “Për mënyrën e zbatimit të Portabilitetit të Numrit” garanton zbatimin e protabilitetit të numrit nga të gjithë sipërmarrësit e rrjeteve publike telefonike dhe ose shërbimeve telefonike të disponueshme për publikun, në përputhje me:
 - zgjidhjet teknike,
 - mënyrën dhe
 - afatet e përcaktuara në këtë rregullore

Të gjithë operatorët, përfshirë ofruesit e shërbimit telefonik fiks dhe të lëvizshëm, në zbatim të Rregullore së portabilitetit, kanë detyrimin që për çdo thirrje pavarësisht se, origjinohet nga brenda apo jashtë rrjetit, duhet të aksesojnë CRDB dhe të kryejnë ACQ dhe më pas të dërgojnë thirrjen drejt rrjetit ku pajtimtari ndodhet në atë cast.

Sa më lart shpjeguar, AKEP arsyeton se, kjo Rregullore, nuk duhet të prekë dhe të interferojë çështje që janë rregulluar me akte të tjera administrative të miratuara nga AKEP, të cilat kanë objekt rregullimin e tarifave, dhe konkretisht disa prej tyre:

- Vendimet nr. 1559-1561, datë 20.04.2011 dhe Vendimet 2176-2179, datë 29.10.2012, kane miratuar disa përcaktime/rregulla, të përfshira në ofertat referencë të operatorëve celulare, në lidhje me rrugëzimin dhe tarifën e terminimit për t’u aplikuar për terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare drejt numrave të portuar në rrjete celulare.
- Vendimi Nr. 2489, datë 26.06.2014, ka amenduar Ofertën Referencë të Interkoneksionit të sipërmarrësit Albtelecom sh.a, në lidhje me thirrjet drejt numrave të portuar në rrjetet fikse.

Sa argumentuam më lart, kërkesa e shprehur nga Albtelecom sh.a. nëpërmjet këtij ankimi për përfshirjen në këtë Rregullore edhe çështje të rregullimit të tarifave drejt numrave të portuar, vlerësojmë se është jashtë fushës së zbatimit dhe objektit të kësaj Rregulloreje.

Edhe vetë Albtelecom sh.a., në bazën ligjore që mbështet këtë ankim ka referuar përveç të tjerash nenet 34, 35, 58/1, të Ligjit Nr. 9918, datë 19.05.2008 "Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Këto nene kanë të bëjnë me analizat e tregjeve dhe tarifave të tregut të komunikimeve elektronike që nuk janë objekt dhe qëllim i këtij akti.

II. Çështja e dytë, të cilën ankimon Albtelecom sh.a., janë elementët operacionale të procesit të protabilitetit të numrit dhe konkretisht, në lidhje me shlyerjen e detyrimeve të abonentit përpara kryerjes së procesit të portimit.

1. Albtelecom sh.a., paraqet argumentet kundër këtyre ndryshimeve të nenit 16, duke theksuar se, nuk e kuptojmë këtë modifikim nga ana e AKEP në këtë nen, pika 6 e Rregullores së miratuar, ku ndërmjet të tjerash është përcaktuar se: *"...duke rimbursuar vetëm vlerën e mbetur përpara ekzekutimit të kërkesës për bartje..."*. Albtelecom sh.a. shprehet se, ky formulim lë të kuptohet se, pajtimtari është përgjegjës vetëm për periudhën përpara ekzekutimit të kërkesës për bartje, ndërkohë që sjellim në vëmendje se, në përgjithësi kontratat e operatorëve parashikojnë se, pajtimtari merr një sërë benefitesh kundrejt detyrimit për një kohëzgjatje minimale të kontratës (*sipas një afati të caktuar, si p.sh. 12 muaj*), me kushtëzimin që çdo lloj shkëputje përpara këtij afati, pajtimtari ka detyrimin për të paguar edhe pajtimet mujore për periudhën e mbetur të kohës së kontraktuar. Me tej në këtë pjesë të ankimit të tij sipërmarrësi Albtelecom sh.a., shtjellon mënyrën e aplikimit dhe rëndësinë e detyrimeve kontraktore.

2. Në konkluzion, të parashtrimeve të mësipërme Albtelecom sh.a., kërkon që, nëse AKEP vendos të sanksionojë përfundimisht këtë parim sipas të cilit, kërkesa për portim nuk do të ekzekutohet deri sa pajtimtari të shlyejë çdo lloj detyrimi që rrjedh nga kontrata, atëherë edhe formulimi i pikës 6 do duhet të reflektojë në mënyrë më të qartë këtë qëllim duke u mjaftuar me formulimin e pikës 6 si më poshtë:

"Pajtimtari duhet të përfundojë dhe të shlyejë të gjitha detyrimet kontraktore përpara ekzekutimit të kërkesës për bartje të numrit" (neni 17, pika 6).

3. Në lidhje me fjalinë e fundit të pikës 6, neni 17 "...Nëse operatori marrës nuk e pranon ose e refuzon aplikimin e pajtimtarit brenda tri ditëve të punës, pajtimtari do të tërheqë aplikimin e tij. Albtelecom sh.a. shprehet se kjo fjali duhet të riformulohet pasi lënë si e tillë, krijon një sërë paqartësish.

- Së pari, çfarë duhet kuptuar në praktikë rasti kur operatori marrës nuk e pranon aplikimin e pajtimtarit brenda 3 ditëve pune? Nëse është rasti që me "pranim" duhet të kuptohet hedhja në sistem e kërkesës së pajtimtarit, atëherë ky kuptim duhet të dale më qartë në fjali.
- Gjithashtu, çfarë kuptimi ka e drejta e pajtimtarit për të tërhequr aplikimin nëse ky aplikim është refuzuar nga operatori. Pra, nëse aplikimi refuzohet, nuk ka më kuptim që abonenti tërhiqet apo jo, aplikimi mbetet i refuzuar.
- Së fundi, cila është forma që zyrtarizon tërheqjen e abonentit kur citohet se pajtimtari do të tërheqë aplikimin e tij?! Paragrafi duhet të parashikojë qartë formën zyrtare që abonenti tërheq aplikimin e tij dhe në mënyrë të qartë rastet kur abonenti mund t'a aplikojë këtë të drejtë.

Sa cituam më sipër, në ankimin e Albtelecom sh.a., lidhur me elementët operacionale të procesit të protabilitetit të numrit, AKEP sqaron se:

1. Vendimi Nr. 2405, datë 26.12.2013 ka miratuar dokumentin me Rregulla për "Termet e Përgjithshme të Kontratës së Pajtimit për Lidhjen dhe Aksesin në Rrjetin Publik të Komunikimeve Elektronike".

Në këto Termet e Përgjithshme të Kontratës, (të cilat referohen edhe në nenin 15, pika 5 e rregullores së portabilitetit) detyrimet kontraktuale të pajtimtarit janë përcaktuar

qartë në Kapitullin IV. Të drejtat dhe detyrimet e pajtimtarit. Përgjegjësitë. Ne kete pjese te Termave te Pergjitheshme, janë përshkruar ne menyre te detajuar elementët që do të përbëjnë një Kontratë Pajtimi për Lidhjen dhe Aksesin në Rrjetin Publik, duke filluar me llojet e shërbimeve, të dhënat, tarifat, pagesat, shkeljet si dhe masat e ndërmarra nga palët etj.

Kategoritë e detyrimeve kontraktore që lidhin me ekzekutimin e kërkesës për bartje, por në asnjë mënyrë me të drejtën e kërkesës për bartje pasi ajo është e padiskutueshme, janë të përcaktuara në nenin 16 të Rregullores paragrafët 5 dhe 6, konkretisht:

5. Pajtimtari duhet t'i paguajë operatorit dhënës të gjitha faturat e papaguara që dalin nga kontrata ekzistuese përpara ekzekutimit të kërkesës për bartje.

6. Pajtimtari duhet të përfundojë të gjitha detyrimet që vijnë si rezultat i përfitimeve të marra nga kontrata ekzistuese që përfshijnë aparate telefonike apo pajisje të ndryshme, duke rimbursuar vetëm vlerën e mbetur përpara ekzekutimit të kërkesës për bartje.

2. Paragrafi i nenit 16 të Rregullores, sanksionon pikërisht atë që është thënë në paragrafët e mëparshëm, pra pajtimtari duhet përfundojë të gjitha detyrimet që vijnë si rezultat i përfitimeve të marra nga kontrata ekzistuese që përfshijnë aparate telefonike apo pajisje të ndryshme, duke rimbursuar vetëm vlerën e mbetur të tyre. Këto detyrime duhet të shlyhen përpara se të **ekzekutohet** kërkesa për bartje, dhe kjo duhet të jetë parashikuar qartësisht dhe në detaje në kontratën e pajtimit. Jane kontratat ata qe normojnë marrëdhëniet bazë kontraktuale midis sipërmarrësit dhe pajtimtarit, respektivisht, për ofrimin dhe përfitimin e shërbimeve publike të komunikimeve elektrokronike, dhe këto rregullime janë pjesë e kontratës së pajtimit. Theksojmë se, në anjë rast asnjë kusht apo klauzolë në kontrate nuk duhet të pengojë të drejtën e bartjes së numrit për pajtimtarin.

3. Shprehja në paragrafin e nenit 17 “Nëse operatori marrës nuk e pranon ose e refuzon aplikimin e pajtimtarit brenda tri ditëve të punës, pajtimtari do të tërheqë aplikimin e tij”, është e lidhur ngushtësisht dhe organikisht me paragrafin paraardhës të këtij neni ku thuhet se:

Operatori marrës do të vazhdojë me procesin e bartjes vetëm nëse pajtimtari nëpërmjet formularit në shtojcën e kësaj rregulloreje ka shprehur dëshirën e tij:

- a) për të ndërprerë pjesërisht ose tërësisht kontratën me operatorin dhënës;
- b) për të lidhur kontratë me operatorin marrës, dhe
- c) për të bartur numrin/numrat nga operatori dhënës tek operatori marrës

që do të thotë se, në se nuk janë plotësuar këto kushte, atëherë operatori marrës ka të drejtë të mos e pranojë apo refuzojë aplikimin. Me qëllim shkurtimit në kohe të një tejzgjatje të përgjigjes nga operatori marrës apo të plotësimit të kriterëve nga pajtimtari është caktuar një afat tre ditor. Në vijim të lehtësimit të procedurave, AKEP nuk ka patur si qëllim përcaktimin e një forme zyrtare të tërheqjes së aplikimit.

2. Në përfundim, Altelecom sh.a., në mbështetje të argumentave të tij të dhëna në ankim, bazën ligjore të cituar në ankim bazuar në nenet 130/1, 131, 132, 133, 134/1,a, dhe 136/4, të Ligjit Nr. 44/2015 dt. 30.04.2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", si dhe bazuar në nenin 7, nenet 34, 35, 58/1, e vijues të Ligjit Nr. 9918, datë 19.05.2008 "Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Altelecom kërkon nga AKEP:

Ndryshimin e Vendimit të Këshillit Drejtues Nr. 2689, datë 22.09.2016, për miratimin e dokumentit "Rregullore për mënyrën e zbatimit të Portabilitetit të Numrit", për ndryshimin e përmbajtjes së Rregullores bashkëlidhur këtij vendimit në lidhje trajtimin e trafikut ndërkombëtar drejt numrave të portuar dhe në lidhje me disa

elementë të tjerë operacionale të funksionimit të procesit të portabilitetit të numrit siç është argumentuar më lart.

III. AKEP, bazuar në arsyetimet, argumentat dhe përfundimet e mësipërme, e konsideron kërkesën dhe pretendimet e sipërmarrësit Albtelecom sh.a. për ndryshimin e Vendimit të Keshillit Drejtues Nr. 2689, datë 22.09.2016 për miratimin e dokumentit "Rregullore për mënyrën e zbatimit të Portabilitetit të Numrit", për ndryshimin e përmbajtjes së Rregullores bashkëlidhur këtij vendimi në lidhje me trajtimin e trafikut ndërkombëtar drejt numrave të portuar dhe në lidhje me disa elementë të tjerë operacionale të funksionimit të procesit të portabilitetit të numrit, të pambështetur ligjërisht.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në sa më sipër, dhe në kompetencat që i janë dhënë nga:

1. Ligji Nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë";
2. Ligji Nr. 9918, datë 19.05.2008, për "Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,

V E N D O S:

1. Rrëzimin e ankimit administrativ të sipërmarrësit Albtelecom sh.a. për ndryshimin e Vendimit të Keshillit Drejtues Nr.2689, date 22.09.2016 përcjellë në AKEP me shkresë nr. Prot., 8677 datë 21.10.2016 (Prot. i AKEP nr. 1706 Prot, datë 21.10.2016).
2. Lënien në fuqi të Vendimit të Këshillit Drejtues Nr. 2689, datë 22.09.2016 për miratimin e dokumentit "Rregullore për mënyrën e zbatimit të Portabilitetit të Numrit".
3. Të njoftohet Albtelecom sh.a. për këtë Vendim;
4. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit www.akep.al.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R

Piro XHIXHO

ANËTARËT E KËSHILLIT DREJTUES:

1. **Alban KARAPICI** _____
2. **Anila DENAJ** _____
3. **Ketrin TOPÇIU** _____
4. **Klarina ALLUSHI** _____